



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo – Republic of Kosovo**  
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel: 383 38 312 309 email: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

**OSHP: 2023/0371**

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105 dhe nenit 106, nenit 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042), i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje nga Vedat Poterqoi - Kryetar, panelist individual, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga Operatori Ekonomik - N.SH. TEST&ING, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: Ekzaminimi I material ndërtimore dhe shqyrtime gjeomekanike me nr. të prokurimit: 651-23-3501-2-2-1, iniciuar nga Kuvendi Komunal - Gjilan, në cilësinë e autoritetit kontraktues, me datën 13/07/2023, mori:

## **Vendim**

1. Hedhet poshtë si e palejuar ankesa e operatorit ekonomik OE “N.SH. TEST&ING”, e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me datën 09/06/2023, numër protokollit 2023/0371, për aktivitetin e prokurimit “Ekzaminimi I material ndërtimore dhe shqyrtime gjeomekanike” me nr. të prokurimit: 651-23-3501-2-2-1, iniciuar nga KUVENDI KOMUNAL-GJILAN, pasi që OE ankues konsiderohet si palë pa interes juridik material, konform nenit 4 paragrafi 1.26 të LPP-së.
2. Mbetet në fuqi, njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues i datës 01.06.2023 për dhënie të kontratës për aktivitetin e prokurimit me titull: Ekzaminimi i material ndërtimore dhe shqyrtime gjeomekanike me nr. të prokurimit: 651-23-3501-2-2-1, iniciuar nga Kuvendi Komunal – Gjilan.
3. Lejohet kthimi i mjeteve të deponuara në emër të tarifës për sigurim të ankesës, konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP. Kurse, ankuesi ka të drejtë që në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga dita e pranimit të këtij Vendimi, të paraqes kërkesë për kthim të mjeteve, në të kundërtën mjetet konfiskohen dhe kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

## **Arsyetim**

*- Faktet dhe rrethanat procedurale -*

Me 13.04.2023, AK - Kuvendi Komunal - Gjilan, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar B05 Njoftimin për Kontratë për aktivitetin e prokurimit me titull:“Ekzaminimi I material ndërtimore dhe shqyrtime gjeomekanike” me nr. të prokurimit: 651-23-3501-2-2-1.

Ndërsa me datën 26.05.2023 AK-Kuvendi Komunal – Gjilan ka publikuar B58 Njoftimin mbi Vendimin e AK, me të cilin shpërblen me kontratë OE “ IPE-PROING ”SH.P.K.

Me datë 18.01.2023 Operatori Ekonomik “N.SH. TEST&ING”, ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim në AK - Kuvendi Komunal – Gjilan për aktivitetin e prokurimit “Ekzaminimi I material ndërtimore dhe shqyrtime gjeomekanike” me nr. të prokurimit: 651-23-3501-2-2-1. Ndërsa me datë 01.06.2023 AK ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim të Operatori Ekonomik.

I pakënaqur me vendimin e AK, me datën 09.06.2023 Operatori ekonomik “N.SH. TEST&ING”, ka parashtruar ankesë në OSHP, me numër 2023/0371.

Me rastin e shqyrtimit paraprak, Paneli Shqyrtues konstatoi se, ankesa në rastin konkret, është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK, çdo palë e interesuar mund të parashtrorë ankesë në OSHP vetëm pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji. Meqë parashtruesi e ka statusin e palës së interesuar në kuptim të nenit 4, paragrafi 1.26, kurse po ashtu ankesa përmban elementet qenësore të parapara me nenin 111, të Ligjit të cituar do të thotë se ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave të cituara dhe e njëjta bije nën kompetencat e tij në kuptim të nenit 105, të LPP.

*- Vlerësimi dhe administrimi i provave –*

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me këtë, me 22.06.2023, eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

- Ankesa e OE ankues të hedhet poshtë si e palejuar.

*Përgjigje në Pretendimet Ankimore të OE ankues "N.SH. TEST&ING"*

Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues ka deponuar ankesën ne OSHP, me pretendimin se autoriteti kontraktues me rastin e rekomandimit për kontratë të OE IPE Pro Ing, nuk ka vepruar në harmoni me dispozitat e LPP-së, konkretisht OE ankues pretendon se AK-Komuna e Gjilanit nuk i ka respektuar dispozitat e nenit 61 lidhur me tenderët Jo-Normalisht të ulët dhe njëherit pretendon se dëshmitë e dorëzuara për inxhinierin e gjeodezisë nuk janë në përputhje të plot me kërkesën e dosjes së tenderit.

Eksperti shqyrtues, fillimisht gjatë analizimit të shkresave të lëndës, konkretisht procesverbalin e hapjes së ofertave dhe formularin B58 – Njoftimin mbi vendimin e AK-se, ka vërejtur se OE ankues Test&Ing renditet i fundit sipas çmimit.

## **NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES**

*Sipas Nenit 43.7 dhe 44.2 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ të Prokurimit Publik*

**Titulli i kontratës i dhënë nga autoriteti kontraktues: " Ekzaminimi I material ndërtimore dhe shqyrtime gjeomekanike " Numri i aktivitetit të prokurimit: GL 651-23-3501-2-2-1.**

<b>Nr.</b>	<b>Emri dhe adresa e Operatorit Ekonomik</b>	<b>Vlera totale e ofertës</b>
1	N.SH. TEST&ING	545.71 euro
2	IPE-PROING SH.P.K.	178.30 euro
3	Grup i Operatorëve Ekonomik IPE CONTROLS - ING SH.P.K.; NORD-COMAT sh.p.k.	208.70 euro

**Komuna e Gjilanit për " Ekzaminimi I material ndërtimore dhe shqyrtime gjeomekanike " Numri i aktivitetit të prokurimit GL 651-23-3501-2-2-1 Komuna e Gjilanit shpërblen si OE të përgjegjshëm OE IPE-PROING SH.P.K. me shumën 178.30 euro për njësi.**

Eksperti shqyrtues, në vazhdim pas shqyrtimit fillestar të ankesës së OE ankues Test&Ing, ka vërejtur se i njëjti në ankesën e tij e ka atakuar vetëm OE të rekomanduar për kontratë, ndërsa nuk e ka atakuar operatorin ekonomik (të dytë sipas çmimit).

Sipas dispozitave të nenit 111 të LPP-së dhe nenit 4.1.26 të LPP-së, me rastin e parashtrimit të ankesës në OSHP, operatori ekonomik duhet të dëshmojë interes juridik e material konform dispozitave të cekura me lartë.

Në rastin konkret eksperti shqyrtues sqaron për operatorin ekonomik se edhe po të kthehej lënda në rivlerësim nuk mund të jetë nënshkruar i kësaj kontrate publike sepse është edhe një operator

tjetër të cilin nuk e ka atakuar përmes ankesës se tij të deponuar në OSHP. Po ashtu OSHP se fundmi në web faqen e saj ka publikuar një njoftim për OE-të se të njëjtit përmes ankesës duhet të dëshmojnë se kanë interes material për aktivitetin e prokurimit për të cilin parashtrajnë ankesë.

[Organi Shqyrtues i Prokurimit | Details \(rks-gov.net\)](#)

Prandaj, eksperti shqyrtues duke u bazuar në sqarimet e dhëna me lart, vlerëson se ankesa e OE ankues nuk është në harmoni me nenin 4.1.26 dhe 111 të LP-së, andaj duhet hudhet posht si e pa lejuar, për mungesë të interesit juridik e material për këtë aktivitet të prokurimit.

*-Mendimi i ekspertit shqyrtues-*

- Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i rekomandon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të hedhet poshtë si e palejuar.

*-Konstatimet e Panelit Shqyrtues-*

Paneli Shqyrtues analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe/ose veprimet e palëve, siç janë përshkruar më sipër (faktet dhe rrethanat procedurale) dhe ka mbajtur seancën e shqyrtimit kryesor me dt. 21.03.2023.

Duke i analizuar pretendimet e ankuesit, përmbajtjen e tyre dhe raportin e ekspertit shqyrtues Paneli Shqyrtues konsideron se:

Duke vepruar mbi bazën e parimeve themelore të procedurave për shqyrtimin e prokurimit, të cilat mes tjerash, janë sanksionuar në mënyre të veçantë me dispozitën e nenit 104, të LPP dhe njëherësh duke i analizuar shkresat e kësaj lënde në relacion me faktet dhe rrethanat e përshkruara si më sipër dhe rrjedhën e procedurës. Sikurse mund të kuptohet edhe nga përmbajtja e ankesës, apriori pretendimet ankimore nuk konsistojnë në faktin nëse është atakuar apo jo interesi ekonomik i Ankuesit. Prandaj parashtruesi i ankesës nuk mund ta ketë statusin e palës me interes në kuptim të paragrafit 1.26, të nenit 4 (Përkufizimet), të LPP, sipas të cilit palë e interesuar është personi që mund të dëshmojë interes material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit. Paneli shqyrtues detyrohet ta marrë në konsideratë faktin parimore se, tenderi i ofruar nga OE ankues sipas shumës së ofruar është i radhitur i 5 (pesti) me radhë në procesin e ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve, i njoftuar zyrtarisht nga AK me anë të letrës standarde për tenderuesin e pa-suksesshëm dhe me anë të pretendimeve ankimore të paraqitura në ankesën e tij e atakon vetëm të rekomanduarin e nuk e argumenton pohimin se operatorët tjerë të radhitur para tij nuk janë të përgjegjshëm, ndërsa OE të cilët janë të radhitur para tij, janë më të lirë për nga çmimi dhe janë të përgjegjshëm.

Në kontekstin shpjegimeve si më sipër, Paneli i vuri në zbatim po ashtu nenin 103, të LPP, sipas të cilit, “Dispozitat e kësaj pjese përcaktojnë të drejtat themelore dhe procedurale dhe mjetet juridike në dispozicion të palëve të interesuara siç është përkufizuar ky term (“palë e interesuar”) në nenin 4 të këtij ligji”. Kuptimi i kësaj dispozite vërteton fare qartë mendimin e këtij Paneli se, mjetet juridike mund të vihen në lëvizje vetëm nga palët e interesuara duke ju referuar në këtë rast pikërisht përkufizimit të dhënë në nenin 4, të LPP.

Prandaj bazuar në kuptimin e nenit 4, të LPP, lidhur me nenin 103 dhe 111, të këtij Ligji, Paneli konsideron se parashtuesi i saj nuk mund të konsiderohet palë e interesuar dhe se nuk ka nevojë të lëshohet në vlerësimin meritore të pohimeve specifike të kësaj Ankese, sepse të njëjtat janë jo lëndore në kuptim të nenit 111, të LPP. Ndërsa, autoriteti kontraktues mbanë përgjegjësi të plotë sa i përket respektimit të dispozitave ligjore për prokurimit publik.

*- Përfundim -*

Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në këtë rast nuk përbejnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të kthehet sërish në ri-vlerësim sepse, kjo bje ndesh me fushëveprimin e LPP dhe bazën argumentuese të pretendimeve ankimore, të cilat Paneli i vlerëson sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 104 lidhur me nenin 105 të LPP. Kthimi i një aktivitetit të prokurimit pa bazë kontestuese ligjore ri-vlerësim, nuk është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: “...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji”.

Lidhur me nenin 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: “Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës...” Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Andaj nga te lartcekurat, paneli shqyrtues ne pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues  
**Vedat Poterqoi**

### **Këshillë juridike:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, dhoma e shkallës së parë, në afat prej 30 ditësh nga e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI KOMUNAL- GJILAN**
- **OE - N.SH. TEST&ING**
- Arkivës së OSHP-së: